



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.21/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat z. [REDAKTUAR], si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDAKTUAR], i dyshuar për shkelje disiplinore gjatë veprimeve përmbardimore në lëndën përmbardimore PPP. Nr 177/2020, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, znj. Znj. Burbuqe Spahii Kerveshi, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i [REDAKTUAR], të cilin e përfaqëson sipas autorizimit [REDAKTUAR] dhe pas seancës këshillimore dhe votimit, me datën 14.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat DPLI -21/2021 datë 04.08.2021, dhe ankesa nga përfaqësuesi i [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], në cilësi të palës ankuese të cilin e përfaqëson [REDAKTUAR] datës 15.07.2021, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbardues-Përmbarduesi Privat, [REDAKTUAR] nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore.

Ar sy e t i m

Me datën 15.07.2021, pala ankuese ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të Ligjit të Procedurës Përmbartimore si dhe ka propozuar të mirren masa disiplinore ndaj përmbartuesit privat. Sipas palës ankuese, përkundër që ndaj përmbartuesit privat, Komisioni Disiplinor kishte konstatuar shkelje, i njëjti vazhdon të mban të bllokuar xhirollogarinë bankare të debitorit dhe të tërheq të holla.

Me datën 04.08.2021, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur në Komision Disiplinor propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat [redacted] si organ përmbartues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 341 par 1 lidhur me nenin 323 par 2, të LPP-së.

Përmbartuesi privat [redacted] në përgjigjen e tij me shkrim deklaron që ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore. Thekson se mjetet ishin ndaluar me dt 11.03.2021 në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbartimore ende pa filluar asnjë procedurë disiplinore ndaj tij. Shton se, si organ përmbartimor, nuk ka pranuar asnjë urdhër nga asnjë organ për deblokimin e kontos të palës debitore. Sipas përmbartuesit privat [redacted] prapësimi ishte refuzuar si i pasafatshëm nga Gjykata dhe ai nuk ka kompetencë të lëshohet në vlerësimin e vendimit gjyqësor pavarësisht nëse ishte apo jo në dijeni që prapësimi ishte bërë apo jo brenda afateve ligjore sepse kjo është kompetencë e gjykatës. Rrjedhimisht, përmbartuesi privat propozon që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Me datën 14.09.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Znj. Burbuqe Spahija Kerveshi, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i palës ankuese përkatësisht përfaqësuesi i [redacted], të cilin e përfaqëson [redacted] ndërsa përmbartuesi privat, z. [redacted] është paraqitur në Objektivin e Ministrisë së Drejtësisë por nuk është lejuar hyrja nga sigurimi i Ministrisë së Drejtësisë për shkak se i njëjti nuk ka arritur të ofroj dëshmi që është vaksionuar apo që ai të ketë rezultuar negativ në testin ndaj pandemisë COVID-19.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Znj. Burbuqe Spahija Kerveshi, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu edhe përfaqësuesi e palës ankuese ka ngelur pranë ankesës së paraqitur me shkrim si dhe ka bërë eleborimin e saj.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se i përmbartuesi privat nuk ka kryer veprë disiplinore.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson se në rastin konkret, përmbaruesi privat z. [REDACTED] nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor pas vendimit DPL- 06/21 të lëshuar ngë Komisionit Disiplinor, i cili kishte konstatuar shkelje disiplinore nga ana e përmbaruesit privat. Shkeljet të cilave i referohet pala ankuese lidhen pikërisht me veprimet e përmbaruesit privat [REDACTED] të cilat tashmë kanë qenë objekt shqyrtimi dhe janë trajtuar nga ana e Komisionit Disiplinor në rastin DPL-06/2021. Gjithashtu, Komisioni gjen me vend të thekson që mandati ligjor i Komisionit Disiplinor është i kufizuar. Komisioni nuk është i thirrur të obligon përmbaruesit privat në ndërmarrjen e veprimeve. Komisioni vlerëson vetëm nëse përmbaruesi privat me veprimet apo mosveprimet e tij apo saj ka kryer apo jo shkelje disiplinore. Kur Komision gjen se përmbaruesi i caktuar privat ka kryer veprë disiplinore, ai shqipton ndonjëren nga masat disiplinore. Procedurat disiplinore nuk janë procedura shtesë apo zëvendësuese të procedurave ligjore gjuqësore ku palët adresojnë pretendimet e tyre.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 21/2021, datë 14.09.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.